



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dostiguar Punëdhënësi/Prodator Received/Delivered	19-08-2022	2	viti god year
Organ Njësia Organ /Jedimica Org./Unit	Nr. Prot. Iti Prot. Prot. No	Shkup a Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
330/SHUK	4822/2022		163



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.607/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.607/2022 të datës 08.07.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi

kundër organit të punësimit/Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 18.08.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.607/2022, e datës 08.07.2022 e parashtruar nga ankuesi**

**A r s y e t i m**

Ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit Drejtësisë, sipas Akt emërimit të datës 21.08.2015, në pozitën "Asistent i Divizionit të Burimeve Njerëzore". Me datën 10.09.2021 ka parashtruar kërkesën me numër të protokollit 3137/2021 lidhur me pezullimin e dakorduar nga puna të zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj ministrie, ndërsa me datën 10.09.2021 Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka nxjerrë Vendimin Nr.920/2021, sipas të cilit ankuesi i është pezulluar marrëdhënia e punës prej datës 01.11.2021 deri në përfundimin e shërbimit konsullor të bashkëshortes së tij në misionin Konsullorë në Stamboll të Turqisë.

Ankuesi i pakënaqur me mos pagesën e trustit pensional nga ana e organit të punësimit pas pezullimit të detyrës zyrtare, me datën 08.07.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 13.07.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Kulturës, Rinisë dhe ndërsa Këshilli me datën 12.08.2022, ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova;** Ankesën me numër të protokollit 3991/2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.920/2021 të datës 10.09.2021 lidhur me pezullimin nga marrëdhënia e punës së ankuesit; Pasqyrën e llogarisë së trustit të ankuesit për periudhën prej 01.08.2002-04.07.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 13.07.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 12.08.2022 nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit lidhur me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit të ankuesit me numër 3525/2015 të datës 21.08.2015 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; E-mailin zyrtar të datës 10.09.2021; Listën e pagës për ankuesin të muajit maj 2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pa lejuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka administruar provat e lëndës, ka konstatuar se: Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datën 10.09.2021 ka nxjerrë Vendimin Nr.920/2021 lidhur me pezullimin e marrëdhënies së punës së ankuesit nga data 01.11.2021 deri në përfundimin e shërbimit konsullor të bashkëshortes së tij në misionin Konsullorë në Stamboll të Turqisë, ku në pikën 2 të dispozitivit të këtij vendimi theksohet fakti se i njëjti shkon me zero orë në listën e pagës. Këtë vendim, ankuesi e ka pranuar përmes e-mailit zyrtar me datën 10.09.2021, ndërsa ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar me datën 08.07.2022, e që është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ”*, andaj në kuptim të kësaj dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesa e ankuesit është e pa lejuar.

Andaj, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.607/2022, datë 18.08.2022

Ardita PERÇUKU-SHYTI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



*Vendimi i dërgohet:*

- ❖ Ankuesit
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.